

POLITIKA E PRIVATËSISË

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS) si kontrollor i përmbledhjeve të të dhënave i ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kundër keqpërdorimit të tyre.

Të dhënat personale përpunohen konform Ligjit, në masën e duhur dhe në mënyrë transparente në raport me subjektin e të dhënave personale (në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente). Përpunimi i të dhënave personale mund të bëhet pas dakordimit parapakisht të marrë nga subjekti i të dhënave personale. Çdo person i cili ka akses tek të dhënat personale është i obliguar që të sigurojë fshehtësi, mbrojtje dhe përpunim të të dhënave në përputhje me ligjin. Për këtë qëllim, AMS-ja zbaton masa përkatëse teknike dhe organizative për mbrojtje nga shkatërrimi i rastësishëm ose paligjshëm i të dhënave personale ose humbjen e tyre të rastësishme. Në pajtim me Ligjin, AMS-ja në drejtim të zbatimit të këtyre masave gjatë përpunimit të të dhënave personale, si dhe harmonizimit me dispozitat ligjore, përcakton person zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Grumbullimi i të dhënave personale

Shqyrtimi i faqes së internetit të AMS-së (www.aso.mk/www.edukacija.aso.mk) është anonim dhe në këtë mënyrë nuk grumbullon të dhëna që do të mundësojnë identifikimin Tuaj personal si, emri, mbiemri, adresa, numri i telefonit ose adresa e postës elektronike (të dhëna personale).

AMS-ja në mënyrë automatike grumbullon të dhëna për kompjuterin tuaj. Këto të dhëna mund të përfshijnë IP adresën tuaj, tipin e shfletuesit, emrin e domejnit, kohën e qasjes dhe faqe të internetit.

Të dhënat e vetme personale të cilat i grumbullojmë nga vizita Juaj e faqes tonë të internetit janë ato që Ju vullnetarisht i dorëzoni për qëllime konkrete, siç janë parashtrimi i pyetjeve dhe/ose mendimeve për çështje të ndryshme nga fusha e tregut të sigurimeve, sigurimi i informatave të kthyeshme, parashtrimi i kërkesave dhe parashtrimi i komentit përkatës në pjesën Akte për debat publik.

Të dhënat Tuaja personale i grumbullojmë drejtëpërdrejtë nga Ju. Gjatë grumbullimit të të dhënave personale , do jeni të informuar për qëllimet specifike për të cilat ato grumbullohen. Të dhënat personale i mbledhim përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë: përmes përdorimit Tuaj të faqes tonë të internetit, përmes postëve elektronike: contact@aso.mk, përmes postës, dhe gojarisht.

Ky informacion nuk zbulon identitetin e individit dhe ruhet dhe përdoret vetëm për të nxjerrë raporte statistikore që do t'i mundësojnë Agjencisë të përmirësojë faqen e saj të internetit.

Cilat janë të drejtat tuaja?

Të drejtat tuaja për të kontrolluar përmledhjet e të dhënave personale, shtimin, modifikimin dhe fshirjen e të dhënave personale, parandalimin e përdorimit të të dhënave personale, ju mund t'i ushtroni duke paraqitur një kërkesë për të përcaktuar shkeljen e së drejtës për mbrojtje të të dhënave personale në AMS, në adresën e mëposhtme: Rr. Maqedonia nr. 25, Pallati Lazar Pop Trajkov, kati 5, 1000 Shkup.

Për informacion shtesë dhe /ose realizim të të drejtave tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të kontaktoni personin tonë të autorizuar për mbrojtjen e të dhënave personale, në postën e mëposhtme elektronike: ratka.celakovski@aso.mk, marsida.petrofski-trajko@aso.mk

Dakordim për grumbullimin e të dhënave personale

Duke u njohur me këtë politikë dhe referimin pasues të shërbimeve tona të internetit, përdoruesit japin pëlqimin ose dakordimin e tyre për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të AMS-së, përmes formave të komunikimit të disponueshëm në faqen tonë të internetit.

Politika e cookies

Në faqen tone të internetit përdorim Cookies të cilat janë skedarë të vegjël që përdoren për grumbullimin e informatave përmes të cilave mundësohet njohje e kompjuterit tuaj gjatë vizitës suaj të ardhshme të faqes sonë të internetit me çfarë mundësohet qasje më e shpejtë. Poashtu, në raste të caktuara, regjistrojmë informata në formë të “Cookies” në kompjuterin tuaj, me qëllim që të përshtatim vizitën e faqes së internetit sipas nevojave dhe zakoneve të juaja. Përmes Cookies nuk grumbullohen informata personale.

Të gjitha informatat që memorohen në kuadër të “Cookies” mund të përdoren vetëm për nevojat e internet-shërbimit dhe atë në mënyrë me të cilën nuk do të rrezikohet privatësia juaj. Колачиња (Cookies)

Cookies

Ne përdorim cookies në faqen tonë të internetit që janë skedarë të vegjël që përbëhen nga shkronja dhe numra që regjistrohen në kompjuterin tuaj ose në celularin tuaj, nga faqet e internetit që vizitoni.

Cookies nuk ruajnë asnjë informacion personal, siç është emri ose adresa Juaj. Ne përdorim cookies në këtë uebfaqe për arsye të mëposhtme: për funksionimin teknik të faqes, për mbledhjen e statistikave totale, anonime, për të kujtuar preferencat tuaja për mënyrën e shfaqjes së faqes (siç është kontrasti me ngjyra ose madhësia e shkronjave) .

Ju mund të vendosni shfletuesin Tuaj të internetit që të refuzojë cookies ose t'ju paralajmërojë sa herë që dërgohen cookie. Nëse zgjidhni këtë mundësi, disa pjesë të faqes së internetit mund të mos funksionojnë siç është parashikuar.